Republika e Kosovës

Republika Kosovo -Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA XI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat
e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr.3

Prishtinë: më 26.10.2026, në orën 09:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Fahrush Rexhepi, Bahrim Shabani, Eman Rrahmani, Kujtim Shala, Teuta Haxhiu, Albert Kinolli dhe Fridon Lala.

Mungoi: Fatma Taçi.

Pjesëmarrës të tjerë: Salih Hoxha, Gëzim Mujaj, Besnik Ramadani, Dervish Bajraktari, Granit Duriqi, përfaqësues të mediave.

Stafi ndihmës i Komisionit: Safet Beqiri dhe Adelina Demolli.

Mbledhjen e kryesoi: Fahrush Rexhepi, zëvendëskryetar i Komisionit.

Fahrush Rexhepi, kryesues, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, e hapi mbledhjen e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 15.10.2026;**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.11/L-006 për Byronë Shtetërore dhe Verifikimin e Konfiskimin e Pasurisë së Pajustifikueshme, me amendamentet e komisionit përgjegjës-raportues nga aspekti i të drejtave dhe interesave të komuniteteve;**
4. **Të ndryshme.**

1. **Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 15.10.2026**

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.11/L-006 për Byronë Shtetërore dhe Verifikimin e Konfiskimin e Pasurisë së Pajustifikueshme, me amendamentet e komisionit përgjegjës-raportues nga aspekti i të drejtave dhe interesave të komuniteteve

Fahrush Rexhepi, kryesues, tha se qëllimi i këtij projektligji është themelimi, organizimi dhe përcaktimi i kompetencave të Byrosë Shtetërore për Verifikimin e Pasurisë së Pajustifikueshme, si dhe përcaktimi i procedurës për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustifikueshme.
Po ashtu, tha se ky projektligj ka gjithsej 88 nene dhe 12 amendamente të propozuara nga komisioni përgjegjës-raportues.
Shtoi se, bazuar në shkresat përcjellëse të këtij projektligji, mund të konstatohet se dispozitat e këtij projektligji nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve në Kosovë.

Pastaj, hapi diskutimin.

Teuta Haxhiu, tha se ky projektligj është sjellë disa herë në Kuvend dhe se kishte shpresuar se Qeveria e kishte seriozisht këtë çështje dhe po e trajtonte atë me seriozitet, por, sipas saj, Qeveria nuk e ka në interes miratimin e këtij ligji, por vetëm e sjell atë për opinion, sa për të thënë se është ndërmarrë një nismë e tillë. Tha se do të dëshironte që ky të ishte një ligj që zbatohet, por në përputhje me rekomandimet e profesionistëve, përfshirë juristët, të cilët sipas saj kanë deklaruar se ky projektligj është antikushtetues. Qeveria ka dashur qëllimisht të ketë një ligj të tillë, i cili nuk mund të zbatohet. Ajo deklaroi se do ta votojë sa herë që një projektligj i tillë të sillet në Kuvend, për të treguar se nuk ka arsye për t'u frikësuar. Gjithashtu, theksoi se kjo tregon se pushteti nuk e ka seriozisht këtë çështje, duke shtuar se ministrat dhe ish-ministrat janë shkelës të Kushtetutës. Nëse ky ligj do të hynte në fuqi, ata do të përballeshin me pasoja, Në këtë kuadër, projektligjin do ta votojë sa herë që të sillet në Kuvend, pavarësisht vlerësimit të saj se ai është antikushtetues, pasi mendon se kjo është një kauzë e pushtetit për t'u paraqitur para opinionit publik.

Albert Kinolli, tha se ka shumë vite që ky projektligj po shqyrtohet nga një komision në tjetrin, dhe për fat të keq, ende nuk është miratuar në Kuvend, duke shpresuar që kësaj radhe të ndodhë e kundërta dhe projektligji të miratohet nga Kuvendi. Tha se nga shqyrtimi i amendamenteve, deputeti Përparim Gruda ka propozuar amendamentin e parë, të dytë, të tretë, të katërt dhe të gjashtë, të cilat nuk e kanë përkrahjen

e Komisionit funksional. Mirëpo, tha se sa është në dijeni, njëri nga amendamentet e propozuara nga deputeti Përparim Gruda është përkrahur nga Komisioni funksional, por këtë amendament nuk e sheh në raportin me amendamente. Sipas tij, duket se bëhet fjalë për amendamentin e pestë, i cili ka marrë miratimin e Komisionit për Legjislacion.

Fahrush Rexhepi, kryesues, tha se nëse ky projektligj bie ndesh me Kushtetutën e Kosovës, siç u shpreh deputetja Haxhiu, një gjë e tillë nuk mund të vërtetohet dhe të konstatohet në këtë fazë. Megjithatë, shtoi se nuk do ta përkrahte një projektligj të tillë, nëse do të ishte i bindur se është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ai theksoi se në këtë fazë nuk mund të konstatohet nëse projektligji bie apo nuk bie ndesh me dispozitat e Kushtetutës së Kosovës.

Teuta Haxhiu, tha se si deputetë, duhet ta respektojnë njëri-tjetrin dhe ka respekt personal për kryesuesin. Megjithatë, duke pasur parasysh se kryesuesit i ka rënë barra për t'i udhëhequr mbledhjet e komisionit, pyeti nëse ai kishte biseduar si zëvendëskryetarin e parë të komisionit, lidhur me këtë çështjeje, edhe me njohës të mirë të kësaj fushe, me qëllim të sqarimit të dilemave lidhur me këtë projektligj.

Fahrush Rexhepi, kryesues, tha se kjo nuk është përgjegjësi e tij dhe ky projektligj ka kaluar nëpër filtrat përkatës, si dhe është shqyrtuar nga organet kompetente dhe ekspertë profesionalë. Për sa i përket qëndrimit të tij, tha se nuk beson se projektligji bie ndesh me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ai theksoi se komisioni është aty, për të diskutuar dhe secili anëtar ka të drejtë të shprehë mendimin e tij personal, lidhur me projektligjin që po shqyrtohet.

Pas diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim projektligjin, dhe pas votimit, konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr.11/L-006 për Byronë Shtetërore dhe Verifikimin e Konfiskimin e Pasurisë së Pajustifikueshme, me amendamentet e komisionit përgjegjës-raportues nga aspekti i të drejtave dhe interesave të komuniteteve, nuk i cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve në Kosovë.

7. Të ndryshme

Teuta Haxhiu, tha se është momenti që, si deputetë, të ngrihet zëri lidhur me rastin e mbrëmshëm, i cili ka tronditur vendin. Ajo u shpreh me shumë sinqeritet, si grua dhe si nënë, lidhur me atë që kishte lexuar në media për vrasjen e një gruaje, e cila kishte paralajmëruar institucionet dhe kishte kërkuar mbrojtje, duke paralajmëruar edhe për rrezikun që i kanosej. Ajo tha se, përkundër këtyre paralajmërimeve, kishte ndodhur një rast i tillë, që sipas saj, përbën kulmin e një dështimi institucional. Prandaj, ajo kërkoi nga

të gjithë deputetët, që të mos pritet vetëm nga gratë që të reagojnë dhe të kërkojnë mbrojtje, por që edhe deputetët të kërkojnë përgjegjësi nga institucionet, për secilin rast, kur është ndërmarrë apo nuk është ndërmarrë ndonjë veprim i papërgjegjshëm, lidhur me rastin në fjalë.
Tha se nuk mund ta hiqte nga mendja shkrimin e lënë nga viktima, përmes të cilit kishte paralajmëruar se jeta e saj ishte në rrezik. Në këtë drejtim, kërkoi dhe u bëri thirrje të gjithë deputetëve që ta kryejnë përgjegjësinë e tyre dhe ta ngrenë zërin për këtë çështje. Ajo theksoi se, në këtë rast ka dështuar shteti dhe se duhet të ngrihet zëri dhe të kërkohet përgjegjësi institucionale.

Fahrush Rexhepi, kryesues, pajtohet plotësisht me shqetësimin e ngritur dhe ndan dhembjen dhe shqetësimin për rastin e mbrëmshëm, si dhe për të gjitha rastet e tjera të ngjashme. Ai theksoi se shqetësimet dhe preokupimet janë të mëdha në shoqërinë tonë.
Më tej, tha se në shoqërinë tonë vërehet se shumë gjëra kanë degraduar, duke shtuar se shqetësimi i tij nuk është personal, por ka të bëjë me gjendjen në të cilën ndodhet vendi dhe me drejtimin në të cilin po shkon shoqëria. Ai shprehu shpresën dhe besimin se, së bashku, do të ketë përmirësime për të gjithë.
Në fund, kryesuesi e konstatoi të mbyllur mbledhjen e Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 09:40.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Fahrush Rexhepi,
Zëvendëskryetar i Komisionit